

Vendim nr. 174 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 34 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALBAN ALIKO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-542, datë 06.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 29, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Alban Aliko është duke vuajtur dënimin penal pranë IEVP-së, Korçë, pasi, me vendimin nr. 33, datë 21.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë

është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentative (5 herë), të parashikuar nga nenet 79/b dhe 22 të Kodit Penal (KP), “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 278/1, 278/3, 278/4 të KP-së, “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a, pika 2, i KP-së. Në zbatim të nenit 55 të KP-së dhe në lidhje me nenet 51 e 334, pika 1, të këtij kodi, ai është dënuar përfundimisht me 20 vjet burgim. Në kohën e dhënies së këtij vendimi, kërkuesi ka qenë i mitur.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 99, datë 20.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për sa i përket cilësimit ligjor të veprave penale dhe deklarimit fajtor të kërkuesit. Ajo ka disponuar për ndryshimin e këtij vendimi, për sa i përket zbatimit të nenit 55 të KP-së, duke e dënuar kërkuesin përfundimisht me 17 vjet burgim.

3. Në datën 30.01.2020 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 5/2020 “Për dhënie amnistie” (ligji nr. 5/2020), i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 17.02.2020 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në këtë fletore, konkretisht në datën 03.03.2020. Në datën 18.06.2021 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (si gjykata e vendit ku është duke u ekzekutuar dënimi) për përfitimin nga amnistia, sipas këtij ligji, duke parashtruar se veprat penale për të cilat akuzohet janë kryer në datën 24.06.2015; në kohën e kryerjes së veprës penale për të cilën është dënuar, ka qenë në moshën 17 vjeç, pra nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç; se i plotëson kërkesat e ligjit nr. 5/2020, bazuar në nenin 3, pika 8, ku parashikohet se të gjithë të dënuarve femra dhe të mitur, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas pikave 2, 4, 5 dhe 7, të këtij neni, u zbritet 1/3-ta e dënimit të mbetur, pavarësisht kriterëve ndaluesë të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji. Po sipas kërkuesit, referuar nenit 2 të ligjit, vendimi i formës së prerë i dënimit të tij është dhënë me vendimin nr. 99, datë 20.11.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, përpara datës 31.12.2019, datë së cilës i referohet ligji për përfitimin e amnistisë. Në këto kushte, bazuar në nenin 3, pika 8, të ligjit, IEVP-ja, Korçë duhet që të përlllogarisë zbritjen e 1/3-ës së dënimit, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për amnistinë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 237, datë 16.09.2021, ka vendosur, rrëzimin e kërkesës së tij me arsyetimin se ai nuk përfiton nga dhënia e amnistisë sipas ligjit nr. 5/2020, i cili jepte amnisti për dënuarin që kishte qenë i mitur në kohën e gjyqimit, në varësi të llojit të veprave penale, si dhe për të dënuarin e mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, pavarësisht

veprës penale të kryer. Sipas gjykatës, veprat penale për të cilat kërkuesi është dënuar kur ka qenë i mitur, parashikohen si kritere ndaluese të amnistisë, ndërsa në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit ai ka mbushur moshën madhore. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pranimin e kërkesës.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin me nr. 144, datë 02.12.2021, ka vendosur, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të njëjtin arsyetim, duke evidentuar se gjykata e shkallës së parë ka interpretuar drejt ligjin, kur në fakt është kërkuesi që e keqinterpreteton atë. Po sipas gjykatës së apelit, konceptet “i dënuar i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale” dhe “i dënuar i mitur” janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe, si të tilla kanë trajtime të ndryshme ligjore. Qenia e të dënuarit i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale lidhet me statusin e tij gjatë hetimit dhe gjykimit, duke përfutur ato të drejta që parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Qenia e të dënuarit të mitur lidhet me moshën ekzakte të tij në kohën e vuajtjes së dënimit, ndërkohë me ligjin nr. 5/2020 ligjvënësi ka zgjedhur përfitime të caktuara nga amnistia në varësi të statusit të të dënuarit që ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale ose që është i mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit. Aty ku ligjvënësi ka pasur vullnet që përfitimin ta ketë ai i dënuar që ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale ka përdorur termin “personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë baras ose nën 18 vjeç”, ndërsa aty ku përfitimi është parashikuar vetëm për të dënuarin e mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit ka përdorur termin “i dënuar i mitur”. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, përfitimi nga amnistia për të dënuarin që ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk rrjedh automatikisht nga statusi që ky i dënuar ka pasur në kohën e kryerjes së veprës penale, por është një përfitim që rrjedh nga plotësimi i kushteve dhe kritereve që ka përcaktuar ligjvënësi, sipas ligjit “Për dhënie amnistie”, që, sipas rastit, mund të parashikojë përfitime për të dënuarit që kanë qenë të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale ose që janë të mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm. Në rastin objekt gjykimi, kërkuesi do të ishte përfitues i uljes së dënimit të parashikuar nga pika 8 e nenit 3 të këtij ligji, nëse në ditën e hyrjes në fuqi të tij do të ishte nën ose baras 18 vjeç, kusht që nuk plotësohet në rastin konkret. Gjithashtu, Gjykata e Apelit është shprehur se sa i përket vendimit gjyqësor nr. 61-(564), datë 06.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të paraqitur nga kërkuesi, në kushtet kur ai nuk është vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose vendim njësuës, nuk është i detyrueshëm për zbatim. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, ka depozituar rekurs,

kërkuesi duke kërkuar, ndryshimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë si dhe vendimin të Gjykatës së Apelit Korçë.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2022-542 datë 06.06.2022, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se çështja është një kërkim që lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Neni 432 i KPP-së, në pikën 1 të tij, parashikon shkaqet për të cilat rekursi mund të bëhet, dhe se ai nuk mund të pranohet pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon ky nen. Pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Po sipas kësaj gjykate, vendimi objekt rekursi është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material penal nr. 5/2020. Përfundimi i gjykatave të faktit se kërkuesi nuk plotëson kriteret për të përfituar nga ky ligj, çmohet i drejtë. Neni 4 i ligjit nr. 5/2020 përcakton se pavarësisht nga parashikimet e pikave 1, 3 dhe 6 të nenit 3 të këtij ligji, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 79/b të KP-së, krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në paragrafët e parë, të katërt, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë të nenit 278 të KP-së dhe vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara nga nenet 333, 333/a dhe 334 të KP-së. Pretendimet e parashtruara në rekurs lidhen me zbatimin e pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 5/2020, duke vënë në diskutim faktin nëse dispozita e referuar më lart, duhet kuptuar si vazhdim i pikës 7 të nenit 3 ose si kategorizim i ri i atyre që nuk përfitojnë. Duke analizuar shkaqet e rekursit në raport me interpretimin ligjor, gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzione të drejta, duke theksuar se pika 8 e nenit 3 të ligjit nr. 5/2020 zbatohet për ato të dënuar të cilët nuk kanë përfituar nga pikat e tjera të këtij ligji, të cilët duhet të përfitojnë ulje në 1/3-ën e dënimit, por me kusht që të jenë të mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit. Pika 8 nuk ka vendosur si përcaktim që të përfitojnë ata të dënuar që janë të mitur në momentin e krimit, prandaj kjo pikë duhet kuptuar si përjashtim për të përfituar (pavarësisht ndalimeve të nenit 4), të gjitha ata të dënuar që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit janë të mitur. Në këtë këndvështrim, Kolegji Penal ka vlerësuar, se me të drejtë gjykatat e faktit kanë rrëzuar kërkesa e kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përfiton nga zbatimi i nenit 3, pika 8 e ligjit nr. 5/2020.

7. Në datën 23.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuessit

8. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në procesin gjyqësor të zhvilluar i janë cenuar;

8.1. *E drejta për të përfituar nga ligji penal favorizues*, bazuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës dhe nenin 3, pika 3, të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

8.2. *Parimi i barazisë para ligjit*, duke qenë se gjykata e rrethit në të cilin kërkuessi po vuan dënimin (IEVP Korçë), bën një interpretim ndryshe të normës ligjore nga gjykata e rrethit, që ka vendosur për sa u përket të bashkëdënuarve të tjerë, të cilët janë duke vuajtur dënimin në IEVP-në Fier. Gjukata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën për të bashkëdënuarit e tjerë, të cilëve u është aplikuar ulja e dënimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjukatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, që do të thotë se mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të ndalet dhe të analizojë legjitimimin *ratione materiae* të kërkuessit, i cili, në ankimin kushtetues individual ka pretenduar cenimin e një procesi

të rregullt ligjor në drejtim të parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues dhe të parimit të barazisë përpara ligjit. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, për sa i përket parimit të barazisë përpara ligjit, me argumentimin se gjykata e rrethit në të cilin kërkuesi po vuan dënimin (IEVP, Korçë), bën një interpretim ndryshe të normës ligjore nga gjykata e rrethit që ka vendosur, për sa u përket të bashkëdënuarve të tjerë, të cilët janë duke vuajtur dënimin në IEVP-në, Fier, duke pranuar kërkesën e tyre dhe duke aplikuar uljen e dënimit.

11. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit të ligjit, vlerëson t'i analizojë zbatimin e këtyre parimeve kushtetuese në këndvështrimin e së drejtës së procesit të rregullt ligjor, në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor

12. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor. Sipas Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 184 datë 19.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke ndjekur edhe qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të

paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund/duhet ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 18 i Kushtetutës parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 27, datë 29.06.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Barazia përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 52, datë 24.07.2017; nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata rithekson se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyt vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji konstaton se kërkuesi në datën 18.06.2021 ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kërkesën me objekt përfitimin nga amnistia, sipas ligjit 5/2020, të hyrë në fuqi në datën 03.03.2020, duke pretenduar se plotëson kërkesat e nenit 3, pika 8, të ligjit nr. 5/2020. Sipas tij, veprat penale për të cilat akuzohet janë kryer në datën 24.06.2015, pra në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në moshën 17 vjeç.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit me arsyetimin se ai ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, por madhor në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 5/2020, për rrjedhojë nuk mund të përfitojë nga ky ligj, pasi pika 8 e nenit 3 të tij i referohet vetëm të dënuarit të mitur, i cili mbart këtë cilësi gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të caktuar në momentin e aplikimit të këtij ligji dhe jo të dënuarve që kanë qenë të mitur në kohën

e kryerjes së veprës penale, por që rezultojnë madhorë në momentin e aplikimit të ligjit, sikurse dhe paraqitet rasti i kërkuesit.

18. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, me të njëjtin argument ligjor të parashtruar në arsyetimin e gjykatës së rrethit. Sipas kësaj gjykate, konceptet “i dënuar i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale” dhe “i dënuar i mitur” janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe, si të tilla, kanë trajtime të ndryshme ligjore. Qenia e të dënuarit i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale lidhet me statusin e tij gjatë hetimit dhe gjykimit, duke përfituar ato të drejta që parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe me moshën ekzakte të tij në kohën e vuajtjes së dënimit. Ndryshe sa pretendohet nga pala kërkuese, përfitimi nga amnistia për të dënuarin që ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk rrjedh automatikisht nga statusi që ky i dënuar ka pasur në kohën e kryerjes së veprës penale, por është një përfitim që rrjedh nga plotësimi i kushteve dhe kriterëve që ka përcaktuar ligjvënësi, sipas ligjit për dhënie amnistie, që sipas rastit mund të parashikojë përfitime për të dënuarit që kanë qenë të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale ose që janë të mitur në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm. Për sa i përket vendimit gjyqësor nr. 61- (564), datë 06.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të paraqitur nga kërkuesi në lidhje me të bashkëdënuarit e tjerë, gjykata e apelit ka vlerësuar se në kushtet kur ai nuk është vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose vendim njësuës, nuk është i detyrueshëm për zbatim prej saj.

19. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se çështja është një kërkim që lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Kolegji ka vlerësuar se vendimi objekt rekursi është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material penal nr. 05/2020; përfundimi i gjykatave të faktit se kërkuesi nuk plotëson kriteret për të përfituar nga ky ligj është i drejtë; neni 4 i ligjit nr. 5/2020 ka përcaktuar të dënuarit që nuk përfitojnë nga kjo amnisti, pavarësisht nga parashikimet e pikave 1, 3 dhe 6 të nenit 3 të këtij ligji, Kolegji ka konstatuar se pretendimet e parashtruara në rekurs lidhen me zbatimin e pikës 8 të nenit 3 të ligjin nr. 5/2020. Në rekurs është vënë në diskutim fakti nëse dispozita e referuar më lart, duhet kuptuar si vazhdim i pikës 7 të nenit 3 apo si kategorizim i ri i atyre që nuk përfitojnë. Duke analizuar shkaqet e rekursit në raport me interpretimin ligjor të gjykatave të faktit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykatat kanë arritur në konkluzione të drejta, edhe për sa i përket pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 5/2020, e cila nuk ka vendosur si përcaktim që të përfitojnë ata të dënuar që janë të mitur në momentin e

krimet, prandaj kjo pikë duhet kuptuar si përjashtim për të përfituar (pavarësisht ndalimeve të nenit 4) të gjithë ata të dënuar që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit janë të mitur.

20. Lidhur me pretendimin se janë dhënë vendime të ndryshme, konstatohet se vendimi i paraqitur nuk është njësuës për praktikën gjyqësore dhe në kushtet kur kërkuesi nuk paraqet ndonjë shkak konkret diskriminimi të tij, ai nuk përbën argument të mjaftueshëm kushtetues se atij i është cenuar parimi i barazisë para ligjit, në kushtet kur vendimet gjyqësore të dhëna në rastin e kërkuesit nuk rezultojnë të jenë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, sipas standardeve kushtetuese. Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të paraqitura prej palëve ndërgjyqëse në secilin rast, ndaj vendimmarrjet e lidhura me bashkautorësinë e veprës penale nga disa persona, por që mbështeten, në dukje, në fakte të njëjta, mund të jenë të ndryshme. Parimi kushtetues i barazisë përpara ligjit, i sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ai presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Po kështu, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për rrjedhojë, Kolegji vëren se nga gjykatat e zakonshme janë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuesi, duke i dhënë përgjigje të argumentuar në lidhje me to, në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit. Në përmbajtje vendimet nuk rezultojnë të jenë të paqarta, kontradiktore ose në mungesë të elementeve formale, në këto kushte vlerësohet se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.